



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 46, datë 20 .11. 2012

P Ë R

**“EMËRTIMIN “KONT LEOPOLD BERTOLD” TË RRUGËS SË RE, QË LIDH
BULEVARDIN ”BAJRAM CURRI” ME RRUGËN ”ALI DEMI””**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Kont Leopold Bertold” të rrugës së re, që lidh bulevardin ”Bajram Curri” me rrugën ”Ali Demi”, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I

1. Të miratojë emërtimin e një prej rrugëve të qytetit të Tiranës, me emërtimin “Kont Leopold Bertold” të rrugës së re, që lidh bulevardin ”Bajram Curri” me rrugën ”Ali Demi”, (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI